



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:205144
Datë: 29.11.2024
Numri i dokumentit: 06522727

Rev.nr.517/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Milena Gjeriq dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. A. nga P., rruga “.....”, hyrja nr.... banesa nr....., kundër të paditurit H. K. nga P., rruga “....” hyrja nr... banesa-lokali nr..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhafer Maliqi, avokat nga P., lidhur me çështjen pengim posedimit, duke vendosur sipas revizionit paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7726/2023, të datës 13.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si i palejuar revizioni i paditësit S. A. nga P., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7726/2023, të datës 13.05.2024.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1012/2012, datë 07.06.2023 ishte vendosur " I. Refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S. A. nga P., rruga “....”, hyrja nr... banesa nr..., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri H. K., nga P., me datë 11.04.2012 e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të banesës e cila gjendet në P., rruga “....”, hyrja nr... banesa nr... mbi lokalit të paditurit i cili në atë mënyrë duke lëshuar muzikë

shurdhuese-kumbuese (me përforcues) të zmadhimit të zërit, duke filluar nga ora 07:00 e mëngjesit e deri në ora 01:00 të mesnatës. Po ashtu të Vërtetohet i padituri me datë 07.04.2012 e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të bodrumit i cili gjendet në P., rruga "...", hyrja nr..., nën lokalit e të paditurit i cili ka thyer tavanin- pllakën e betonit të lokalit të tij në 11 vende dhe i ka ngjit gypat e kanalizimit të ËC dhe të ujit, jo në sipërfaqen e banjos brenda lokalit të tij, por nën tavanin e bodrumit të paditësit, ku rrjedhin ujërat e zeza dhe vërshojnë dyshtemenë e bodrumit, duke ia ngushtuar hapësirën e shfrytëzimit të bodrumit. Si dhe të Vërtetohet se i padituri me datë 09.05.2022 e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e lirë të banesës e cila gjendet në P., rruga "...", hyrja nr..., banesa nr..., mbi lokalit e të paditurit i cili në atë mënyrë ka vendosur tre gypa të gjerë për thithjen dhe largimin e tymit të duhanit, njërin në pjesën e përparme-para dritareve dhe ballkonit të banesës të paditësit, ndërsa dy gypa në anën e mbrapme nën dritaret e banesës të paditësit, duke i shkaktuar erë të keqe të duhanit, helm dhe dëme, duke e rrezikuar jetën e tij dhe të anëtarëve të familjes, dhe të Urdhërohet i padituri në afat prej 3 ditësh të ndërpres pengimin e paditësit në shfrytëzimin e lirë të banesës në atë mënyrë të heqë muzikën shurdhuese-kumbuese (me përforcues) të zmadhimit të zërit, të heqë të gjitha gypat e përmendur nga bodrumi i paditësit dhe ti vendos-montojë mbi sipërfaqen e lokalit të tij dhe ujërat e zeza-kanalizimin dhe ujërat tjera ti vendosë vetëm në një vertikale të gypit të kanalizimit, ashtu siç kanë qenë në gjendjen e mëparshme para pengimit, si dhe në të ardhmen të përmbahet nga pengimet e tilla, krejt këto nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. II. Hedhet e palejueshme pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit S. A. nga P., me të cilën ka kërkuar që të Detyrohet i padituri H. K. nga P., t'i kompensojë dëmin e shkaktuar paditësit në punët ndërtimore në bodrumin e tij në shumë prej 2,220.00€. III. Detyrohet paditësi S. A. nga P., që të paditurit H. K. nga P., në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë shumën prej 1,049.00€ në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit në dorëzim nën kërcënim të përmbarimit forcërisht."

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7726/2023, të datës 13.05.2024, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit S. A. nga P., ndërsa aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.7726/2023, i datës 13.05.2024, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, të aprovohet revizioni dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe ai i gjykatës së shkallës së parë të anulohen si dhe çështja të kthehet në rigjykim.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i paditësit është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 481.4, të Ligjit Për Procedurën Kontestimore parashihet se "Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar". Prandaj, duke qenë se, me aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë është refuzuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, i cili është marrë në procedurën për kontestet e pengim posedimit, sipas dispozitës ligjore të sipër cekur, rezulton se revizioni në kontestet e pengim posedimit, nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2, pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221, lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.517/2024, datë 25.11.2024

Kryetari kolegjit

Beshir Islami